



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES  
SHTABI I PËRGJITHSHËM I FORCAVE TË ARMATOSURA  
KOMANDA E FORCËS AJRORE

Nr. 3488 Prot.

Tiranë, më 14.10.2020

Lënda Kërkesë për publikim pozicioni të lirë pune

MINISTRISË SË MBROJTJES

QENDRËS SË KULTURËS, MEDIAVE, BOTIMEVE, MUZEUT DHE SHTËPIVE  
TË PUSHIMIT

Tiranë

Në mbështetje të pikës 8, të nenit 7, germës “dh” pika 4 dhe pika 8 të nenit 18 të ligjit nr. 64/2014, datë 26.06.2014 “Për Pushtetet dhe Autoritetet e Drejtimit e të Komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, pikave 3 dhe 8 të kreu II, pikës 3.5 të kreu III të urdhrit të Ministrit të Mbrojtjes nr.1090, datë 02.06.2016 “Për miratimin e politikës dhe procedurës së menaxhimit të personelit civil në Forcat e Armatosura, që nuk gëzojnë statusin e nënpunësit civil”, i ndryshuar, ju dërgoj për publikim në faqen zyrtare funksionin e lirë të punës “Teknik i mesëm (Elektriçist)”, në Repartin Ushtarak, nr. 3002, Rinas, në Forcën Ajrore.


Bashkëlidhur Aneksi A.

KOMANDANTI

Në mungesë

ZËVENDËSKOMANDANTI

Kolonel Ylli Pulaj



**SHPLLJE E VENDI TË LIRË TË PUNËS**

Forca Ajrore

Tabela .1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Teknik i mesëm (Elektriçist)	Reparti ushtarak nr.3002, Forca Ajrore	Rinas, Tiranë.	Me afat të pacaktuar (3 muajt e parë periudhë prove)	Me dosje		15.10.2020	29.10.2020

**Formulari nr. 1**

1. Pozicioni i punës:	Teknik i mesëm (Elektriçist).
2. Kodi i pozicionit:	C2
3. Reparti/Institucioni:	Reparti Ushtarak nr.3002, Forca Ajrore.
4. Vendi:	Rinas, Tiranë
5. Paga:	VKM Nr.202 datë 15.03.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr.717, datë 23.06.2009 Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nënpunësve të disa institucioneve buxhetore", i rrdyshuar, Lidhja II, II/1 me Klasën VI, ( 34.500). Urdhrit të MM nr. 1706, datë 13.10.2015 "Për shtesë mbi pagë për punë të vështirë e të dëmshme për shëndetin" I/a, II/a, b, f (5340).
6. Lloji i kontratës së punës:	Me afat të pacaktuar (3 muajt e parë periudhë prove)
7. Data e fillimit të aplikimit:	15.10.2020
8. Data e mbylljes së aplikimit:	29.10.2020
9. Mënyra e aplikimit:	Me dosje
10. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:	
a. Grada/Titulli:	Civil me arsim të mesëm.
b. Arsimi :	Mesëm profesional (elektrike).
c. Kualifikimi:	Të ketë eksperiencë pune si elektriçist.  Të ketë aftësi të mira organizuese dhe komunikuese.
d. Trajnimi:	Të ketë kryer trajnime të ndryshme në lidhje me specialitetin e kërkuar.
e. Eksperienca në Punë:	Të ketë eksperiencë pune mbi 3 vjet si elektriçist.
f. Gjuha angleze:	E pa aplikueshme.

- g. Kërkesa të tjera specifike: Të njohë dhe zbatoj procedurat e punës për fushën e veprimit.  
h. Niveli i certifikatës së sigurisë: E pa aplikueshme.

## 11. Përshkrimi i punës:

**Detyrat kryesore:** Organizimi dhe koordinimi i punës për njohjen e gjendjes së rrjetit dhe instalimeve elektrike të ndërtesave, objekteve, ambjenteve të brendshme dhe të jashtëme.

Informon mbi gjendjen e rrjetit dhe sistemit elektrik të zyrave, objekteve dhe ndërtesave të Forcës Ajrore.

Të kontrollojë çdo ditë sistemin e ndriçimit dhe të eliminoj defektet e mundshme.

Të kontrolloj në mënyre periodike sistemin elektrik.

Të instruktojë personelin për përdorimin e pajisjeve elektrike për sigurimin teknik dhe uljen e konsumit të energjisë elektrike.

Të marrë masat për sigurimin e ndriçimit alternativ në raste të defekteve në sistemin elektrik

Të njohë shumë mirë skemat elektrike, sistemet e komandimit dhe automatizimit të pajisjeve elektrike.

Të njohë dhe zbatojë me korrektësi masat e sigurimit teknik gjatë punës me pajisjet dhe instalimet elektrike.

Hartoj dhe përpilon të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.

Ndjek në çdo kohë zbatimin e urdhrave e udhëzimeve, evidentimin e problemeve të instalimeve dhe pajisjeve elektrike dhe bën propozimet përkatëse për eliminimin e tyre.

Kryen detyra shtesë në përshtatje me nevojat e shërbimit kur kërkohet nga eprori.

**Përgjegjësitë:** Përgjigjet për gjendjen dhe gadishmërinë e rrjetit dhe sistemit elektrik të objekteve dhe plotësimin e dokumentacionit përkatës.

## 12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- i. Grada/Titulli: Civil (CII);  
j. Arsimi: Mesëm profesional (elektrike).  
k. Kualifikimi: Të ketë eksperiencë pune si elektriciist.

Të ketë aftësi shumë të mira organizuese dhe komunikuese.

- Trajnimi: Të ketë përfunduar kurse e trajnime profesionale për elektriciist.
- l. Eksperienca në Punë: Të ketë eksperiencë pune mbi 3 vjet si elektriciist.  
m. Gjuha e huaj: E pa aplikueshme.  
n. Kërkesa të tjera specifike: Të njohë dhe zbatoj procedurat e punës për fushën e veprimit.  
o. Niveli i certifikatës së sigurisë: E pa aplikueshme.

### 13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta.

Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;

Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Komisioni i ngritur me urdhër në Komandën e Forcës Ajrore, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët.

Komisioni verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit.

Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurrimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse);

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.

**SHEFI I PERSONELIT**

**NËNKOLONEL VLADIMIR JAUPI**



## *Dokumentat e aplikimit per pune:*

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentat e mëposhtëm

- Kërkesën personale;
- Formularin e aplikimit;
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Dëftesë e shkollës së mesme të noterizuar me origjinalin;
- Diplomë e arsimit të lartë/liste notash të noterizuar me origjinalin;
- Fotokopje të patentës nëse ka;
- Dëshmi profesioni nëse ka;
- Çertifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja;
- Raport mjekësor;
- Fotografji me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12, 2 cope;
- Dëshmi penaliteti;
- Vërtetim nga gjykata;
- Vërtetim nga prokuroria;
- Librezë pune;
- Jetëshkrimin (CV).
- Formularin e vetëdeklarimit.